



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 4371 / 6 Prot.

Tiranë, më 11.03.2022

VENDIM

Nr. 25 Date 11.03. 2022

PËR

**HAPJEN E PROCESIT PËR APLIKIM TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË TË TË
KOMISIONEVE TË DOKTORATURËS NË PROGRAMET RESPEKTIVE, NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**

Në zbatim të neneve 38, 46 (pika 1, 2, 3) të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, të nenit 20 të Statutit të UST- së, në nenin 10 të Rregullores së UST-së, në kushtet e miratimit të hapjes së programeve të studimit të ciklit të tretë “Studime Doktorale” me Urdhërat nr. 95, dt. 25.02.2022 dhe nr. 98, dt. 25.02.22 të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e dates 11.03.2022

Vendosi:

1. Të hapë thirrjen për shprehje interesi të profesioratit të UST-së për të kandiduar si anëtarë të komisioneve të doktoraturës në programet respektive si më poshtë:
 - Komisionit të Programit “Shkenca Sportive”, i FSHL;
 - Komisionit të Programit “Aktiviteti Fizik dhe Shendet”, i FVFR;
2. Rregjistrimi të bëhet pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UST-së nga data 16.03.2022 - 25.03.2022.
3. Kandidatët e interesuar në momentin e aplikimit duhet të cilësojnë qartë emrin e komisionit ku vetëkandidojnë.
4. Sekretaria e Senatit Akademik të përpilojë “Thirrjen e Hapur” për të gjithë të profesioratin e UST-së me të dhënat e sakta për kriteret, mënyrën, vendin dhe periudhën kohore të aplikimit.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, drejtuesit e njësive kryesore si dhe Sekretari i Senatit Akademik.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

REKTOR

